

Njoftim për përqendrim me të cilin ENNA Power shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, Vukovar, Kroaci do të fitojë kontroll mbi Lumen Alpha d.o.o. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime, Zagreb, Kroaci

(lënda nr. 08-101/2026)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16, 83/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 208/24 dhe 16/25), më datë 12.06.2026, pranë Komisionit për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim për përqendrim me të cilin **ENNA Power shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime (ENNA Power d.o.o.)**, me seli të regjistruar në adresën Zona Ekonomike Vukovar 13, Vukovar, Kroaci, do të fitojë kontroll të pavarur mbi shoqërinë **Lumen Alpha d.o.o. shoqëri me përgjegjësi të kufizuar për shërbime (Lumen Alpha)**, me seli të regjistruar në adresën Dragutin Golik 89, Zagreb, Kroaci.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre afariste:

ENNA Power d.o.o. është një shoqëri e themeluar dhe ekziston në përputhje me ligjet e Republikës së Kroacisë dhe merret me zhvillimin e projekteve për sisteme të baterive për ruajtjen e energjisë elektrike në Kroaci dhe Evropë. Sistemet e baterive për ruajtjen e energjisë elektrike mundësojnë ruajtjen e energjisë dhe dërgimin e saj fleksibël në përputhje me kërkesën.

ENNA Power d.o.o. është investitor kryesor dhe një nga grupet investuese me rritjen më të shpejtë në Kroaci, i cili është i përkushtuar në ofrimin e zgjidhjeve inovative që nxisin transformimin e gjelbër dhe krijojnë vlerë afatgjatë për partnerët dhe komunitetin, si në sektorin e energjisë, ashtu edhe në sektorin e transportit, përkatësisht logjistikës.

ENNA Power d.o.o. është në pronësi 100% të ENERGIJA NATURALIS d.o.o. për investime dhe menaxhim ((ENERGIJA NATURALIS d.o.o. za ulaganje i upravljanje), e cila është në pronësi të shoqërisë SUSTAINABLE SOLUTIONS HOLDING AG, pronari i së cilës është personi fizik PV. PV është pronar i fundit edhe i grupit FORTENOVA, i cili është i pranishëm në tregun e Republikës së Maqedonisë së Veriut përmes Shoqërisë për prodhim, tregti dhe shërbime MERCATOR MAKEDONIJA SHPKNJP Shkup - në likuidim, me NUAS 5938848 dhe seli në rr. Ognjan Prica nr. 1/3-28 mezanin, Shkup – Kisella Vodë, me veprimtari prioritare të regjistruar: Tregti me pakicë në dyqane të pa specializuara, kryesisht me ushqim, pije dhe duhan. Shoqëria e përmendur nuk është aktive komercialisht dhe është në procedurë likuidimi. Grupi ENNA dhe grupi FORTENOVA së bashku emërohen si "Grupi PV". Grupi PV realizon të ardhura në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shitjes së produkteve ushqimore si vajra ushqimorë, margarinë, majonezë, ujëra mineralë dhe lëngje, salc) dhe shurupe, si dhe produkte të mishit të tharë.

Lumen Alpha d.o.o. është një shoqëri e themeluar dhe ekziston në përputhje me ligjet e Republikës së Kroacisë. E njëjta është bartëse e dy projekteve për sisteme të baterive për ruajtjen e energjisë elektrike (BESS), edhe atë: BESS Buzet 1, me fuqi prej 9,99 MW dhe kapacitet prej 20 MWh dhe BESS Buzet 2, me fuqi prej 9,99 MW dhe kapacitet prej 20 MWh.

Lumen Alpha d.o.o. nuk ka prani në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe nuk realizon të ardhura në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Për nevojat e vlerësimit të përqendrimit në fjalë, parashtruesi i njoftimit propozon që tregu përkatës të definohet si tregu i ruajtjes së energjisë elektrike në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraparak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bjerë nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar lidhur me këtë çështje mbetet i rezervuar.

Komisioni i fton palët e treta të interesuara që t'i dorëzojnë vërejtjet dhe mendimet e tyre lidhur me këtë përqendrim Komisionit. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. „Shën Kirili dhe Metodi“ nr. 54, Shkup, ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk, dhe të njëjtat duhet të arrijnë në Komision brenda afatit prej 10 ditësh nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

18.06.2026

Shkup